LIGJ
Nr.9258, datë 15.7.2004

PËR MASAT KUNDËR FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

Në mbështetje të neneve 78 pika 1 dhe 83 pikat 1 e 2 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPË RISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton masat kundër financimit të terrorizmit, kompetencat dhe marrëdhëniet ndërmjet organeve të ngarkuara për propozimin, miratimin, kontrollin, si dhe zbatimin e tyre.

Neni 2
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është parandalimi i veprimtarive dhe goditja e subjekteve terroriste dhe e atyre që mbështesin dhe e financojnë terrorizmin, duke bllokuar dhe sekuestruar fondet e pasuritë e tyre, sipas rezolutave përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuarara, akteve të organizatave të tjera ndërkombëtare e marrëveshjeve ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Neni 3
Përkufizime

Në kuptim të këtij 1igji, përveçse kur përcaktohet shprehimisht ndryshe në dispozita të veçanta të tij, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

1. "Bllokim i përkohshëm" është ndalimi i çdo transanksioni ose pjesëmarrjeje në transferimin, shndërrimin, tjetërsimin ose lëvizjen e fondeve dhe të pasurive të tjera, sipas kushteve dhe kohëzgjatjes së vlefshmërisë të veprimeve të ndërmarra nga organet përkatëse, në përputhje me këtë ligj. Fondet dhe pasuritë e tjera, të bllokuara përkohësisht, mbeten në pronësi të personave, që kanë të drejtë pronësie mbi to në çastin e vendosjes së masës të bllokimit të përkohshëm.

2. "Sekuestrim" është ndalimi i çdo transanksioni ose pjesëmarrjeje në transferimin, shndërrimin, tjetërsimin ose lëvizjen e fondeve dhe të pasurive të tjera, sipas kushteve dhe kohëzgjatjes së vlefshmërisë të veprimeve të ndërmarra nga organet përkatëse, në përputhje me këtë ligj. Fondet ose pasuritë e sekuestruara mbeten në pronësi të personave, që kanë të drejtë pronësie mbi to në çastin e vendosjes së masës të sekuestrimit.

Pas vendosjes së masës të sekuestrimit, organet përgjegjëse ushtrojnë të gjitha të drejtat e kontrollit mbi fondet dhe pasuritë e tjera të sekuestruara, përfshirë posedimin, administrimin dhe veprime të tjera, që i çmojnë të nevojshme.

3. "Fond dhe pasuri të tjera" janë pasuritë financiare dhe pronat e çdo lloji, të 1uajtshme ose të paluajtshme, pavarësisht nga mënyra e fitimit, si dhe dokumentet ligjore apo instrumentet e çdo lloji, përfshirë ato elektronike ose dixhitale, që provojnë pronësinë ose interesat në këto fonde dhe pasuri të tjera. Këtu përfshihen, por pa u kufizuar vetëm në to, kreditë bankare, çeqet bankare ose të udhëtarëve, urdhërpagesat, aksionet, letrat me vlerë, bonot, pagesat, letërkreditet dhe çfarëdo interesi, dividendi ose të ardhurat e tjera, si dhe vlerat, që grumbullohen a gjenerohen nga fonde ose pasuri të tjera.

4. "Terrorist" është çdo person fizik, që dyshohet se ka kryer ose ka tentuar të kryejë, në mënyrë të vullnetshme, akte terroriste me çfarëdo mjeti, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ose që ka marrë pjesë si bashkëpunëtor në akte terroriste a në financimin e tyre, që ka organizuar ose drejtuar persona të tjerë për të kryer akte terroriste ose për t'i financuar ato, që ka kontribuar me dashje ose duke pasur dijeni për kryerjen e akteve terroriste apo për financimin e tyre nga një grup personash, që veprojnë për një qëllim të përbashkët.

5. "Subjekt terrorist" është çdo person juridik, çdo formë organizimi a sipërmarrjeje ose një ent tjetër, që zotërohet ose kontrollohet nga terroristët.

6. "Person që financon terrorizmin" është çdo person që siguron a grumbullon, me çfarëdo mjeti, drejtpërdrejt ose tërthorazi, fonde dhe pasuri të tjera, që mund të përdoren tërësisht ose pjesërisht për kryerjen e akteve terroriste apo çdo person që vepron për llogari të këtyre personave, në emër a nën drejtimin e tyre. Në këtë kategori përfshihen personat që ofrojnë ose grumbullojnë fonde dhe pasuri të tjera për t'u përdorur apo që kanë dijeni se do të përdoren për kryejen e akteve terroriste.

7. "Person i shpallur" është çdo person, shtetas shqiptar, i huaj ose pa shtetësi, si dhe çdo person juridik, i regjistruar ose jo, që është cilësuar dhe është përfshirë në listë si terrorist, subjekt terrorist a person që financon terrorizmin ose personat për të cilët janë marrë vendime të ngjashme në mbështetje të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të akteve përkatëse të organizatave ndërkombëtare ose të marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

8. "Person i interesuar" është çdo person që ka ose pretendon se ka një të drejtë të ligjshme pronësie a pasurore në fonde dhe pasuritë e tjera të personit të shpallur.

Neni 4

Fusha e zbatimit të ligjit

1. Ky ligj zbatohet ndaj personave të shpallur për vepra të terrorizmit dhe të financimit të tij, të kryera brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Ky ligj zbatohet edhe për vepra penale të terrorizmit, si dhe për fondet e pasuritë e tjera që kanë shërbyer për financimin e terrorizmit, të kryera përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 5

Persona të shpallur

1. Në zbatim të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Këshilli i Ministrave, në përputhje me parimet dhe procedurat e parashikuara në këtë ligj, vendos përfshirjen në listë të personave të shpallur sipas këtyre rezolutave, si dhe marrjen e masave të nevojshme ndaj tyre.

2. Këshilli i Ministrave mund të vendosë përfshirjen në listë edhe të personave të shpallur nga aktet e organizatave të tjera ndërkombëtare ose nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Neni 6

Masa për fondet dhe pasuritë e tjera të personave të shpallur

Për fondet dhe pasuritë e tjera të personave të shpallur nga Këshilli i Ministrave, sipas këtij ligji, persona të shpallur, Ministri i Financave urdhëron marrjen e një ose të disa prej masave të mëposhtme:

a) bllokimin e përkohshëm;

b) sekuestrimin;

c) ndalimin për t'i dhënë shërbime financiare, fonde, mjete financiare ose pasuri të tjera.

KREU II

ORGANET PËRGJEGJËSE DHE DETYRIMET E SUBJEKTEVE PËR TË BASHKËPUNUAR

Neni 7

Organet përgjegjëse për masat kundër financimit të terrorizmit

1. Këshilli i Ministrave nxjerr vendime për miratimin, ndryshimin ose revokimin e listës së

personave të shpallur, sipas nenit 5 pikat 1 dhe 2 të këtij ligji, si dhe për çështje të tjera, që lidhen me masat kundër financimit të terrorizmit.

2. Ministri i Financave është organi përgjegjës për zbatimin e masave kundër financimit të terrorizmit dhe për nxjerrjen e zbatimin e akteve për masat e parashikuara në nenin 6 të këtij ligji.

Neni 8

Administrimi i të dhënave

1. Mbledhja, përpunimi, sistemimi, analiza, ruajtja, përdorimi, shkëmbimi dhe paraqitja e të dhënave për zbatimin e masave kundër terrorizmit, sipas këtij ligji, bëhen nga Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave.

2. Ministri i Financave, Ministri i Rendit Publik, Prokurori i Përgjithshëm, Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit dhe drejtuesit e shërbimeve të tjera informative, sipas fushës dhe përgjegjësive, caktojnë bashkërisht rregullat për njoftimin, mbledhjen, shkëmbimin dhe përdorimin e të dhënave për personat e shpallur, të dhënat ose dyshimet për veprime financiare, transanksione ose veprime të tjera, që kanë për qëllim financimin e terrorizmit.

3. Ministri i Financave kujdeset për zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërkombëtar për hetimin, shkëmbimin e të dhënave dhe kryerjen e veprimtarive të tjera për masat kundër financimit të terrorizmit.

Neni 9

Mbledhja e të dhënave

1. Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave merr masa për mbledhjen dhe administrimin e të dhënave për:

a) personat e shpallur;

b) fondet dhe pasuritë e tjera që disponojnë ose lidhen me të drejta a interesa të tjerë të personave të shpallur.

2. Mbledhja, administrimi dhe ruajtja e të dhënave bëhen në formë dokumentare dhe elektronike.

3. Rregullat e hollësishme për administrimin, ruajtjen, klasifikimin e të dhënave, për rastet dhe mënyrën e njoftimit, si dhe për bërjen publike të akteve e të të dhënave, sipas këtij neni, caktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Neni 10

Detyrimi për informim dhe raportim

1. Çdo person, që ka dijeni për veprime financiare, transanksione ose veprime të tjera, që kanë për qëllim financimin e terrorizmit, është i detyruar të njoftojë menjëherë Ministrin e Financave, Drejtorinë e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave ose strukturat e tjera, të ngarkuara me zbulimin dhe hetimin e veprave penale.

2. Personat e ngarkuar për identifikim dhe raportim, sipas ligjit nr.8610, datë 17.5.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave", janë të detyruar të njoftojnë menjëherë Drejtorinë e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave kur kanë të dhëna ose dyshime për veprime financiare, transanksione ose veprime të tjera, që kanë për qëllim financimin e terrorizmit, pavarësisht nga vlera e tyre. Në çdo rast, Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave ushtron të drejtat dhe detyrimet përkatëse, të parashikuara në ligjin e përmendur më lart.

3. Njoftimi dhe raportimi, sipas pikës 2, duhet të përmbajnë të dhënat për identifikimin e fondeve dhe të pasurive të tjera, të dhënat për pronësinë dhe interesa të tjerë rreth tyre, si dhe shpjegime për motivet ku mbështeten të dhënat e arsyeshme për financim të terrorizmit.

4. Në rastet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 Ministri i Financave mund të vendosë menjëherë, pa detyrimin e njoftimit paraprak, pezullimin e një operacioni ose transanksioni, për një periudhë deri në 7 ditë pune, duke filluar nga dita e parë pas asaj të hyrjes në fuqi të urdhrit. Njëkohësisht, i njofton menjëherë Prokurorit të Përgjithshëm të dhënat e nevojshme për këtë transanksion ose veprim, për efekt të procedimit të mundshëm penal.

Neni 11

Mbrojtja e identitetit të personave që japin njoftime

1. Organet përgjegjëse, që marrin të dhëna, njoftime dhe raportime në zbatim të këtij ligji, janë të detyruara të ruajnë anonimatin e personave që kanë dhënë njoftime.

2. Këshilli i Ministrave miraton rregulla të hollësishme për masat dhe procedurat e ruajtjes së anonimatit të personave që japin njoftime në përputhje me këtë ligj.

Neni 12

Ndalimi i publikimit të të dhënave

1. Të dhënat e siguruara në zbatim të këtij ligji mund të përdoren vetëm për qëllimet e zbatimit të ligjit, për qëllime të ndjekjes penale ose për qëllime të tjera, të caktuara me ligj.

2. Organet përgjegjëse, subjektet e raportimit dhe personat e punësuar pranë tyre, që marrin të dhëna, njoftime dhe raportime në zbatim të këtij ligji, nuk mund të bëjnë publike fakte, për të cilat janë vënë në dijeni gjatë ose për shkak të detyrës.

3. Organet përgjegjëse, subjektet e raportimit dhe personat e punësuar pranë tyre detyrohen t'i vënë në dispozicion gjykatës dokumentet e kërkuara, si dhe të dëshmojnë vetëm në rastet e lejuara në nenin 160 të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 13

Mbrojtja e subjekteve në mirëbesim

Çdo person, që përmbush ose kërkon të përmbushë në mirëbesim detyrimet, sipas dispozitave të këtij ligji, nuk mund të paditet, të procedohet penalisht a t'i nënshtrohet një veprimi të ngjashëm ose të vihet para çdo lloj përgjegjësie tjetër për këtë shkak.

KREU III

LISTA E PERSONAVE TË SHPALLUR

Neni 14

Verifikimi i identitetit, i fondeve dhe i pasurive të tjera

1. Ministri i Financave, në bashkërendim me organet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 8 të këtij ligji, bën verifikimin e identitetit të personave që u nënshtrohen procedurave si person i shpallur, si dhe të fondeve e të pasurive të tjera të zotëruara, të kontrolluara ose ku ata kanë ndonjë të drejtë a interes tjetër.

2. Në çastin më të parë të mundshëm, por jo më vonë se 7 ditë nga njoftimi, organet e përmenduara në pikën 2 të nenit 8 të këtij ligji i paraqesin Ministrit të Financave, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, një raport me shkrim, ku jepen:

a) të dhënat e arsyeshme që personi i shpallur ka të drejta dhe interesa në fondet dhe pasuritë e tjera;

b) pamundësia e vlerësimit brenda afatit të përcaktuar në këtë pikë, nëse personi i shpallur ka të drejta dhe interesa në fondet dhe pasuritë e tjera.

Neni 15

Kriteret për hartimin e listës së personave të shpallur dhe për marrjen e masave kundër fondeve dhe pasurive të tjera

1. Në rastin e parashikuar në pikën 1 të nenit 5 të këtij ligji, përcaktimet nga strukturat dhe rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara përbëjnë të dhëna të arsyeshme, për të krijuar bindjen se personi është terrorist, subjekt terrorist ose person që financon terrorizmin. Në këto raste Këshilli i Ministrave detyrimisht vendos për përfshirjen e tyre në listën e personave të shpallur.

2. Në rastin e parashikuar në pikën 2 të nenit 5 të këtij ligji Këshilli i Ministrave, në marrjen e vendimit, mbështetet në të dhënat e arsyeshme ku pa u kufizuar vetëm në to, mund të përfshihen aktet e nxjerra nga organizatat ndërkombëtare ose nga marrëveshjet ndërkombëtare, ku Shqipëria është palë.

Aktet mund të plotësohen me informacionet e paraqitura nga Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, nga organet e ndjekjes penale, shërbimet informative të shtetit, institucionet e tjera, kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe në informacione të siguruara nga mbajtësit e fondeve dhe të pasurive të tjera, sipas parashikimeve të nenit 10 të këtij ligji.

3. Ministri i Financave, mbështetur në dokumentacionin e parashtruar sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, i propozon Këshillit të Ministrave përfshirjen në listën e personave të shpallur ose përcaktimin e një personi si person i shpallur, si dhe merr masat për bllokimin e përkohshëm të fondeve dhe pasurive të tjera të tij.

4. Masat e parashikuara në nenin 6 të këtij ligji vendosen për të gjitha fondet dhe pasuritë e tjera ku personi i shpallur ushtron të drejta pronësie, kontrolli ose të drejta a interesa të tjerë.

5. Masat e parashikuara në nenin 6 të këtij ligji vendosen pavarësisht nga fakti se kush i ka në zotërim a përdorim fondet apo pasuritë e tjera, sikurse edhe për çdo fond dhe pasuri tjetër, që është gjetur në posedim ose mbahet nga persona të shpallur.

6. Zbatimi i masës së bllokimit të përkohshëm ose të sekuestrimit nuk pengon mbledhjen e interesave dhe marrjen e përfitimeve nga fondet dhe pasuritë e tjera. Këto masa shtrihen automatikisht edhe mbi fonde dhe pasuri të tjera që fitohen pas zbatimit të tyre.

7. Nuk lejohen veprime ose transanksione për fondet dhe pasuritë e tjera të bllokuara përkohësisht, përveç rasteve të parashikuara shprehimisht në ligj dhe përcaktimeve të bëra në bazë të tij në aktin përkatës të bllokimit të përkohshëm.

Neni 16

Bllokimi i përkohshëm

1. Ministri i Financave urdhëron menjëherë bllokimin e përkohshëm të fondeve dhe pasurive të tjera të një personi të shpallur edhe përpara nxjerrjes së vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, sipas nenit 18 të këtij ligji, kur çmon se kjo është e vetmja mënyrë për të parandaluar shmangien nga zbatimi i masave të parashikuara në këtë ligj ose për të siguruar efektivitetin e tyre. 2. Urdhri i Ministrit të Financave për bllokimin e përkohshëm të fondeve dhe të pasurive të tjera hyn në fuqi menjëherë dhe është i vlefshëm për një periudhë jo më shumë se 30 ditë pune, duke filluar nga dita e parë pas nxjerrjes së urdhrit.

3. Kur ka të dhëna për kryerjen e një akti terrorist ose për financimin e terrorizmit, Ministri i Financave urdhëron bllokimin e përkohshëm të fondeve dhe të pasurive të tjera sipas këtij neni dhe njofton menjëherë Prokurorin e Përgjithshëm, duke i dërguar të dhënat e nevojshme për të dyshuarin dhe për fondet e pasuritë e tjera të tij.

Neni 17

Ankimi kundër bllokimit të përkohshëm

1. Kundër urdhrit të Ministrit të Financave për bllokimin e përkohshëm të fondeve dhe të pasurive të tjera, të nxjerrë sipas pikës 1 të nenit 16 të këtij ligji, personit të interesuar i lind e drejta të bëjë ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë.

2. Gjykata e shqyrton çështjen brenda 10 ditëve, duke zbatuar dispozitat për gjykimet administrative. Në çdo rast, ankimimi nuk pezullon ekzekutimin e menjëhershëm të urdhrit të Ministrit të Financave.

3. Personi i interesuar ka detyrimin të provojë para gjykatës se:

a) ka një të drejtë të ligjshme në fondet dhe pasuritë e tjera të personit të shpallur;

b) ka burime të justifikuara ligjërisht për të drejtat dhe interesat e tij në fondet dhe pasuritë e tjera;

c) fondet dhe pasuritë e tjera, objekt gjykimi, nuk kanë lidhje me terroristë, subjekte terroriste, persona që financojnë terrorizmin ose persona të tjerë të lidhur me ta.

4. Personi i interesuar quhet i njoftuar nga data kur ka marrë dijeni për nxjerrjen e urdhrit. Në çdo rast, çështja shqyrtohet brenda afatit të treguar në pikën 2 të këtij neni, nëse Ministri i Financave ose përfaqësuesi i tij paraqet të dhëna të mjaftueshme për pamundësinë e gjetjes së adresës, të vendndodhjes së personit të interesuar ose të pranisë së tij brenda afatit ligjor të shqyrtimit të çështjes.

5. Në rastin e bllokimit të një pasurie të paluajtshme, kopja e urdhrit të bllokimit të

përkohshëm dhe e vendimit të gjykatës i dërgohet zyrës që merret me pasuritë e paluajtshme. Kjo e fundit është e detyruar të marrë masa për ekzekutimin e menjëhershëm të tyre.

Neni 18
Vendimi i Këshillit të Ministrave

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave, vendos miratimin, ndryshimin ose revokimin e listës së personave të shpallur, për të cilët zbatohen masat kundër financimit të terrorizmit, si dhe për çështjet që lidhen me sekuestrimin e fondeve dhe të pasurive të tyre.

2. Vendimi i Këshillit të Ministrave hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Neni 19
Ankimimi kundër vendimit të Këshillit të Ministrave

1. Personi i shpallur mund të bëjë ankim të veçantë kundër vendimit të Këshillit të Ministrave në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë brenda 15 ditëve nga marrja dijeni. E drejta e ankimit mund të ushtrohet vetëm në rastin kur personi pretendon se është identifikuar gabimisht me personin e shpallur.

2. Gjykata e shqyrton çështjen duke zbatuar dispozitat për gjykimet administrative. Në çdo rast ankimimi nuk pezullon ekzekutimin e menjëhershëm të vendimit dhe të masave të tjera, që merren në zbatim të tij.

Neni 20
Zbatimi i vendimit të Këshillit të Ministrave

1. Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave, Ministri i Financave merr masa për bllokimin e përkohshëm ose për sekuestrimin e administrimin e të gjitha fondeve dhe pasurive të tjera ose transanksioneve, që kanë të bëjnë me sigurimin e këtyre fondeve dhe të pasurive të tjera të personave të shpallur.

2. Në rastin e sekuestrimit të një pasurie të paluajtshme, kopja e akteve përkatëse dhe e vendimit të gjykatës i dërgohen zyrës përkatëse të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Kjo e fundit është e detyruar të marrë masa për ekzekutimin e menjëhershëm të tyre.

3. Për administrimin e pasurive të bllokuara e të sekuestruara, sipas këtij ligji, zbatohen dispozitat në fuqi për strukturat përgjegjëse dhe procedurat për fondet dhe pasuritë e sekuestruara të konfiskuara në procedime penale ose jashtë tyre.

Neni 21
Shpenzime të lejuara nga fondet dhe pasuritë e tjera

1. Ministri i Financave, brenda 72 orëve nga paraqitja e kërkesës, autorizon pagesa nga fondet dhe pasuritë e tjera të sekuestruara, për t'i përdorur për nevoja mjekësore, familjare dhe vetjake të personit të shpallur, për pagimin e detyrimeve ndaj shtetit ose të atyre që rrjedhin nga puna e kryer dhe sigurimet e detyrueshme.

2. Kundër urdhrit të Ministrit të Financave për refuzimin e autorizimit të kërkuar mund të bëhet ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë. Në çdo rast, ankimimi nuk pezullon ekzekutimin e menjëhershëm të vendimit dhe të masave të tjera që merren në zbatim të tij.

3. Ministri i Financave vendos rregulla dhe procedura të hollësishme për shpenzimet e lejueshme, duke pasur parasysh kriteret e parashikuara në rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Neni 22
Ankimi i personave të interesuar dhe i personave të tretë

1. Personat e interesuar dhe personat e tretë, që pretendojnë se janë në mirëbesim, mund t'i kërkojnë të drejtat e tyre mbi fondet dhe pasuritë e tjera të sekuestruara duke bërë ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë jo më vonë se 30 ditë nga marrja dijeni për aktin e sekuestrimit. Në çdo rast,

ankimimi nuk pezullon ekzekutimin e menjëhershëm të vendimit dhe të masave të tjera, që merren në zbatim të tij.

2. Personat e interesuar dhe personat e tretë, që pretendojnë se janë në mirëbesim, zbatojnë detyrimet e parashikuara në pikën 3 të nenit 17 të këtij ligji.

Neni 23

Ndryshimi dhe revokimi i vendimit për personat e shpallur

1. Këshilli i Ministrave mund të vendosë ndryshimin ose revokimin e vendimit për listën e personave të shpallur brenda 15 ditëve nga paraqitja e propozimit të Ministrit të Financave ose mbi ankimin e personit të shpallur, të shoqëruar me shpjegimet për ndryshimin e rrethanave përkatëse, që kanë motivuar nxjerrjen e tij.

2. Efektet e ndryshimit ose të revokimit të masave të marra ndaj personave të shpallur fillojnë shtatë ditë pas datës së botimit të vendimit në Fletoren Zyrtare.

3. Ndryshimi ose revokimi i vendimit të Këshillit të Ministrave për listën e personave të shpallur bëhet vetëm kur vërtetohen rrethana dhe fakte, që e bëjnë të panevojshëm zbatimin e mëtejshëm të tij, për shkak të:

a) një vendimi të mëvonshëm të strukturave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, sipas Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, për rastet e parashikuara në pikën 1 të nenit 6 të këtij ligji;

b) një detyrimi që i kërkohet ose i lind Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 25 të Kartës së Kombeve të Bashkuara;

c) një vendimi përkatës të organizatave të tjera ndërkombëtare ose sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

KREU IV
SANKSIONET

Neni 24

Kundërvajtjet administrative

1. Nëse nuk përbën vepër penale, mospërmbushja nga subjektet e detyrimeve të parashikuara në këtë ligj dhe në 1igjin nr.8610, datë 17.5.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave", i ndryshuar, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 50 mijë deri në 10 milonë 1ekë, si dhe me detyrimin në favor të shtetit të vlerës, fondit dhe të pasurisë tjetër, ku vërtetohet se ka një interes personi i shpallur.

2. Dënimet administrative, sipas pikës 1 të këtij neni, vendosen nga Ministri i Financave.

3. Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të vendimeve për kundërvajtjet administrative bëhen në përputhje me ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative", i ndryshuar.

KREU V
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 25

Procedimi penal

Pavarësisht nga zbatimi i dispozitave të këtij ligji, prokuroria dhe gjykata, në zbatim të dispozitave procedurale penale, mund të procedojnë me sekuestrimin dhe konfiskimin e fondeve dhe të pasurive të tjera, të bllokuara përkohësisht ose të sekuestruara në zbatim të këtij ligji.

Neni 26

Miratimi i akteve nënligjore

Ngarkohen organet përgjegjëse, sipas këtij ligji, që brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e tij, të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të neneve 7, 9 pika 3, 11 pika 2 dhe 21 pika 3.

Neni 27

Rregulla të brendshme

Brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, në përputhje me detyrimet përkatëse, autoritetet mbikëqyrëse dhe subjektet e përmendura në nenin 3 të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave", i ndryshuar, duhet të miratojnë dhe të zbatojnë rregullat e brendshme, të posaçme, për kriteret dhe procedurat e identifikimit të veprimeve, të transanksioneve dhe të personave të dyshimtë për lidhje me financimin e terrorizmit, si dhe për identifikimin e veprimeve financiare, të transanksioneve dhe veprimeve të tjera të dyshimta për financim të terrorizmit.

Neni 28

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4281, datë 26.7.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu